

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**QENDRA E STUDIMEVE ALBANOLOGJIKE**  
**KOMISIONI INSTITUCIONAL I ZGJEDHJEVE**

Nr. 2 Prot

Tiranë, më 19.07.2017

**OBJEKTI: Hapja e procesit të regjistrimit të kandidatëve për autoritetet dhe organet drejtuese në QSA**

**VENDIM**

Bazuar në ligjin nr. 8485, dt. 12.05. 1999 “Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar dhe nenit 131 të ligjit nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, të Rregullores “Për organizimin e zgjedhjeve të para për autoritetet dhe organet drejtuese në institucionet publike të arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, urdhërin e Ministrit të Arsimit dhe Sportit nr. 361, dt. 11.07.2017 dhe Rregulloren “Për organizimin e zgjedhjeve të para për autoritetet dhe organet drejtuese në institucionet publike të arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”;

Komisioni Institucional i Zgjedhjeve vendosi hapjen e procesit të regjistrimit të kandidatëve për drejtor të QSA-së dhe Senat Akademik.

Të gjithë të interesuarit për t’u vetëkandiduar për drejtor të QSA-së dhe Senatit Akademik (anëtarë të personelit akademik) duhet të plotësojnë formularin e vetëdeklarimit për këtë pozicion. Në bazë të Nenit 24, Pika 2 të Rregullores “Për organizimin e zgjedhjeve të para për autoritetet dhe organet drejtuese në institucionet publike të arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”: - Formulari i vetëdeklarimit tërhiqet pranë zyrës së KIZ.

Dorëzimi i aplikimit bëhet pranë KIZ-it në zyrën e sekretares Sabina Dhrimo, pranë godinës qendrore të QSA-së, Sheshi “Nënë Tereza”, Nr. 3.

Afati i fundit i pranimit të aplikimeve është ditën e hënë, dt. 24.07.2017, ora 16.00.

**Kryetar:**

**Sali Kadria**

Ferid Hudhri

Hasan Bello



**Sekretare:**

**Sabina Dhrimo**

Elio Hobdari

Rafaela Marteta